



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:262896

Datë: 29.07.2021

Numri i dokumentit: 02040924

A.nr.1002/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Edona Grajçevci, në konfliktin administrativ të paditësit Sh.B. nga fshati , komuna e Podujevës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.F., avokat nga Podujeva me adresë në Rruga “”, Podujevë, kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit nr.03/888/17, i datës 11.05.2017 të të paditurës, pas shqyrtimit kryesor publik, me datë 13.07.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Sh.B. nga fshati Ll., komuna e Podujevës.

II. ANULOHET vendimi nr.03/888/17, i datës 11.05.2017 i Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, u mbajt në pajtim me nenin 41 të LKA-së, pa praninë e palëve ndërgjyqëse të ftuara në mënyrë të rregullt.

Paditësi me padinë e datës 14.06.2017, kishte pohuar se e paditura me vendimin nr.03/888/17, i datës 11.05.2017 e ka refuzuar ankesën e paditësit Sh.B. nga fshati , komuna e Podujevës të cilën e ka ushtruar kundër aktvendimit Nr. 08-466-1 të datës 06.03.2017 të Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi KK-Podujevë. Paditësi në tërësi e kundërshton aktvendimin e të paditurës duke e konsideruar të kundërligjshëm për shkak se me rastin e marrjes së aktvendimit të kundërligjshëm, e paditura nuk ka aplikuar drejt dispozitat e procedurës administrative dhe ato

materiale. Shton se nuk është e vërtetë që e ka uzurpuar pjesën e ngastrës nr. 00597-1 me kulturë kullosë kl.2 me sipërfaqe prej 985 m², për shkak se këtë paluajtshmëri e ka në posedim dhe shfrytëzim babai i tij N.B. e jo paditësit dhe se të njëjtën babai i tij e ka në posedim dhe shfrytëzim të pandërprerë dhe të papenguar nga askush që disa dekada dhe se këtë paluajtshmëri babai i paditësit e ka trashëguar nga babai i vet. Më tutje shton se e drejta e pronës është kategori kushtetuese dhe e drejtë sendore e cila bartësit të saj i mundëson posedimin, përdorimin, shfrytëzimin dhe disponimin e sendit të caktuar brenda kufijve të paraparë me ligj, prandaj duke u bazuar në dispozitat e lartëcekura konsideron që aktvendimi i të paditurës është i kundërligjshëm dhe i pabazuar për çka edhe i njëjti nuk mund të mbetet në fuqi e nga këto arsye i propozon Gjykatës që pas administrimit të provave të marr Aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit dhe e anulon aktvendimin e të paditurës nr.03/888/17, i datës 11.05.2017.

Paditësi, sikurse përfaqësuesi i tij munguan në seancën e shqyrtimit kryesor. Përfaqësuesi i paditësit me parashtresën e datës 09.07.2021, kishte kërkuar nga Gjykata shtyerjen e seancës me asrjetimin se nga ora 10 do të merrte pjesë në një seancë tjetër, mirëpo Gjykata e refuzoi të njëjtën.

E paditura në Përgjigjen në padi të datës 17.06.2019 kishte deklaruar ndër të tjera, se: *“AKK-ja pas analizimit të gjitha shkresave të lëndës ka konstauar se organi i shkallës së parë, ka nxjerrë aktvendim në bazë të nenit 16, 17 dhe 18 të Ligjit mbi Shqyrtimin e Marrëdhënieve Pasurore të Krijuara me Uzurpimin Arbitrar të Tokës në Pronësinë Shoqërore (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 46/77) duke e shpallur uzurpues arbitrar të Pronës shoqërore në sipërfaqe prej 985 m². Në pjesën e ngastrës kadastrale nr. 00597-1, me kulturë kullosë, kl.2 në sipërfaqe të përgjithshme prej 15660 m², në vendin e quajtur “Lagjja e Sokolve” në Zonën Kadastrale Ll., pronë komunale e Komunës së Podujevës (fleta poseduese nr. 3179). Në sipërfaqen e uzurpuar të pronës shoqërore, uzurpuesi ka ndërtuar objekt-ndërtesë për banim dhe murin e oborrit me material të fortë ndërtimor. Ankuesi përveç thënieve ankimore te AKK-së, nuk i ka ofruar asnjë provë materiale me të cilën do të mbështet pretendimet e tija dhe të rezultonte ndonjë vendim tjetër nga vendimi i Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Podujevës.*

Në bazë të shkresave të lëndës dhe provave me të cilat disponon AKK-ja, është vlerësuar si i bazuar aktvendimi i atakuar Nr. 08-466-1 i datës 06.03.2017 dhe u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi i cili është definitiv në procedurën administrative dhe hyn në fuqi nga momenti i procedimit të tij. Pas shqyrtimit të lëndës, kërkon nga Gjykata që të marr Aktgjykim me të cilin e refuzon padinë e paditësit si të pabazuar dhe e vërteton aktvendimin me nr. 03/888/17 të datës 11.05.2017 të AKK-së”.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, e paditura nuk ka qenë prezente.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: Aktvendimi nr. 03/888/17 i dt. 10.05.2017, padia në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Dega Podujevë e datës 11.04.2017, aktvendimi i Drejtorisë për Pronë Kadastër dhe Gjeodezi nr. 08-466-1 i dt. 06.03.2017, shkresa me titull

Informata e pronës e dt. 02.03.2017, shkresa me te dhënat e tatim paguesit, kopja e planit, ekstrakti nga fletë posedimi e dt.13.10.2005, ekstrakti nga fletë posedimi nr. 09-04/1160 i dt.14.08.2007, kopja e planit me nr. 09104/1160 e dt. 14.08.2007, vërtetimi me nr. 00-21819294 i dt. 20.04.2017, kopja e letërnjoftimit të paditësit, ankesa e dt. 19.04.2017, fleta poseduese me nr. te lëndës 08-942-03/31579 e dt. 20.04.2017, procesverbali i Drejtorisë për prone Kadastër dhe Gjeodezi i dt. 01.03.2017, skica nga AKK e dt. 27.02.2017, procesverbali i Drejtorisë për prone Kadastër dhe Gjeodezi i dt. 27.02.2017 si dhe konkluzioni me nr. 08-466-1 i dt. 27.02.2017.

Gjykata shqyrtoi provat e lartcekura dhe pretendimet e paditësit lidhur me kërkesëpadinë e tij dhe gjeti se padia është e bazuar.

Në këtë drejtim, gjykata gjeti se paditësi, i pakënaqur me vendimin e Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi të Komunës së Podujevës, ishte ankuar tek AKK-ja si organ i shkallës së dytë dhe se e njëjta përsëri i kishte refuzuar ankesën përmes vendimit nr.03/888/17, i datës 11.05.2017, me ç'rast, paditësi kishte ngritur konflikt administrativ në këtë Gjykatë.

Në lidhje me vendimin e goditur me padi, gjykata gjeti se dispozitivi është në kundërshtim të plotë me arsyetimin, se në pjesën e arsytimit, e paditura nuk ka dhënë prova konkrete e as nuk ka trajtuar pretendimet ankimore të paditësit, në përputhje të plotë me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.¹ Arsyetimi i ri në lidhje me të gjitha pretendimet ankimore të ankuesit, në këtë rast paditësit, duhet të jetë i plotë dhe të trajtoj secilën kërkesë të përgjithshme e të veçantë të ankuesit në procedurë administrative.

Gjykata gjeti se me përgjigjen në padi, e paditura kryesisht ka përshkruar kronologjinë e procedurës administrative, duke u përqendruar vetëm në veprimet e njëanshme të ndërmarra nga ana e saj dhe duke mos dhënë fakte e as shpjegime të nevojshme ligjore mbi atë se cilat pretendime ankimore të paditësit i ka marrë parasysht dhe cilat jo.

Gjykata poashtu gjeti se në procedurën që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit, respektivisht vendimit të kundërshtuar të shkallës së dytë, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se me Konkluzionin Nr. 08-466-1 të datës 27.02.2017, organi administrativ i shkallës së parë, fillon procedurën administrative duke paragjykuar qartazi epilogun e përfundimit të kësaj procedure. Në këtë drejtim, gjykata gjeti se fraza: “*HAPET procedura administrative sipas detyrës zyrtare me qëllim të konstatimit të uzurpimit të tokës në pronësinë shoqërore kundër Sh.B. nga fshati Ll...[vazhdon fjalia]*”, përbën trajtim të pabarabartë të paditësit në procedurë administrative e me këtë, e paditura ka shkelur nenin 6 [Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit]² si dhe nenin 7 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme

¹ Neni 132 Procedura e shqyrtimit të ankesës nga organi epror i LPPA-së:

3. Nëse organi epror vlerëson se pjesa urdhëruese (dispozitivi) i aktit të ankimuar është i ligjshëm, por arsyet e dhëna janë të tjera nga ato që i ka dhënë organi kompetent publik në aktin e ankimuar, apo vlerëson se arsyetimi i tij nuk është i plotë, ai do të refuzojë ankesën dhe do të paraqes arsyetimin e ri, gjegjësisht do ta plotësojë arsyetimin aktit të ankimuar.

² Neni 6

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

1. Organi publik vepron në pajtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit.

2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse.

Administrative [Parimi i objektivitetit dhe paanësisë]³, për faktin që nuk mund të filloj asnjë procedurë administrative duke e paragjykuar përfundimin e saj, përkundrazi, organi i administratës, pavarësisht shkallshmërisë, procedurën administrative duhet ta nis duke u siguruar që qasja duhet të jetë objektive dhe e paanshme si ndaj subjektit në procedurë, poashtu edhe ndaj objektit të procedurës që trajtohet.

Gjykata poashtu konstatoi shkeljen e parimit të objektivitetit dhe paanësisë nga organi i shkallës së parë, në procedurën e cila i ka paraprirë nxjerrjes së aktit të organit administrativ të shkallës së dytë. Kjo shkelje evidentohet në Procesverbalin mbi dëgjimin e pales i datës 01.03.2017 i përpiluar në Drejtorinë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Podujevës, ku ndër të tjera thuhet: *“Personi zyrtar e njoftoi palën se është ftuar në këtë Drejtori për shkak të uzurpimit të pronës së paluajtshme shoqërore të Komunës në pjesën e njësisë kadastrale nr. 597-1 në sipërfaqe prej 985 m² ZK Ll.”*. Njëjtë, sikurse edhe citimet e lartëcekura në procesverbal, paragjykimi i epilogut të procedurës administrative të filluar dhe zhvilluar nga organi administrative i shkallës së parë, është i ndaluar me Ligjin për Procedurën Administrative, përkatësisht në mënyrë specifike i sanksionuar në nenin 6, paragrafin 3 të të njëjtit Ligj, i cili përcakton që: *“Organi publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë, ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit”*.

Organi i paditur duhet të ftoj paditësin që të ofroj të gjithë dokumentacionin e nevojshëm i cili i paraprin ankesës dhe në përputhje me nenin 6, 7 dhe 8 të LPPA-së, të marr vendim të drejtë dhe të ligjshëm. Secili vendim për pretendimet ankimore të paditësit, duhet të jetë i arsyetuar mirë dhe në rastin kur një apo më shumë pretendime ankimore refuzohen nga e paditura, e njëjta duhet të jap shpjegime ligjore dhe të arsyetoj se pse dhe në çfarë mase është refuzuar pretendimi ankimor i paditësit.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative- juridike është shkelur ligji në dëm të paditësit, andaj organi i paditur do të ketë parasysh theksimet nga kërkesa e paditësit.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Gjatë ri procedimit, e paditura duhet të përqendrohet në trajtimin specifik të secilit pretendim të paditësit dhe sa më shumë që të jetë e mundur të evitohet përdorimin dhe citimin e dispozitave të panevojshme ligjore, të zbatohet drejtë, saktë dhe pa paragjykime e pa diskriminim të drejtën materiale, në mënyrë që arsyetimi i vendimit të jetë në përputhje të plotë me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

3. *Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit.*

³ *Neni 7-Parimi i objektivitetit dhe paanësisë 1. Organi publik duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme. 2. Veprimet e zyrtarit publik nuk duhet të ndikohen nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor, politik apo nga presioni politik.*

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, u mor duke u bazuar në nenin 64 të LKA-së.

Në bazë të asaj që u tha më lartë e në kuptim të nenit 5, 6, 29, 38 si dhe nenit 46, paragrafit 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr. 1002/17, datë 13.07.2021

G j y q t a r i

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate